

Në bazë të nenit 3 dhe 4, nenit 39, paragrafit 1 dhe nenit 40, paragrafit 1 të Ligjit për pronën shtetërore ("Fleta zyrtare e Malit të Zi" nr. 21/09 dhe 40/11), Rregullorja mbi shitjen dhe dhënien me qira të sendeve në pronë shtetërore (Fleta Zyrtare të Malit të Zi), Nr. 44/10), neneve 28, 29 dhe 30 të Vendimit për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 20/20), Vendimi mbi dhënien me qira të truallit përmes mbledhjes së ofertave me qëllim të vendosjes së objekteve të përkohshme "Fleta Zyrtare e Malit të Zi - Dispozitat Komunale", Nr. 09/22), nenit 28 dhe 29 të Vendimit për dhënien e pëlqimit Komunës së Tuzit për zbatimin e procedurës për dhënien me qira të truallit në territorin e saj me qëllim të vendosjes së objekteve të përkohshme ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 20/20). Sekretariati për pronë shpall:

### THIRRJE PUBLIKE

#### nr. 1

#### për dhënien me qira të truallit për vendosjen e objekteve të përkohshme të karakterit montues përmes mbledhje së ofertave

lënda e thirrjes publike është dhënia me qira e truallit për vendosjen e objekteve të përkohshme të karakterit montues përmes mbledhje së ofertave, në lokacionet vijuese:

nr. i lokacionit	Lloji i objektit sipas mënyrës se si është lidhur me bazën	Parcela kadastrale	Lloji i objekteve sipas qëllimit	Sipërfaqja	Çmimi mujor minimal i qirasë së truallit pa TVSH
1.9	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Tezgë	4 m <sup>2</sup>	5 eur
1.10	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Tezgë	4 m <sup>2</sup>	5 eur
1.11	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Objekt për organizimin e eventeve (skenë)	20 m <sup>2</sup>	25 eur
1.1	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Kioskë	5.50 m <sup>2</sup>	6,87 eur
1.2	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Kioskë	6.00 m <sup>2</sup>	7,5 eur
1.3	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Kioskë	5.50 m <sup>2</sup>	6,87 eur
1.4	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Banak i hapur me tarracë	30.00 m <sup>2</sup>	37,5 eur
1.5	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Banak i hapur me tarracë	30.00 m <sup>2</sup>	37,5 eur
1.6	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Banak i hapur me tarracë	25.00 m <sup>2</sup>	31,25 eur

1.7	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Banak i hapur me tarracë	25.00 m <sup>2</sup>	31,25 eur
1.8	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Banak i hapur me tarracë	25.00 m <sup>2</sup>	31,25 eur
2.1	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2315/3 KK Tuz	Kioskë	6 m <sup>2</sup>	4,5 eur
2.2	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2315/3 KK Tuz	Kioskë	6 m <sup>2</sup>	4,5 eur
2.3	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2315/3 KK Tuz	Kioskë	6 m <sup>2</sup>	4,5 eur
3.1	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Kioskë	18 m <sup>2</sup>	13,5 eur
4.1	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	3205 KK Tuz	Kioskë	6 m <sup>2</sup>	1,90 eur
4.2	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	3205 KK Tuz	Vendndalesa e autobusit	6 m <sup>2</sup>	1,90 eur
5.1	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2315/4 KK Tuz	Billbord	10 m <sup>2</sup>	7,5 eur
5.2	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2315/4 KK Tuz	Vendndalesa e autobusit	6 m <sup>2</sup>	4,5 eur
12.1	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2242 KK Tuz	Billbord tre-anësor	20 m <sup>2</sup>	22,5 eur
12.2	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2242 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
12.3	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2242 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
15.1	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord një-anësor	6 m <sup>2</sup>	6,75 eur
15.2	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord një-anësor	6 m <sup>2</sup>	6,75 eur
15.3	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord një-anësor	6 m <sup>2</sup>	6,75 eur
15.4	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord një-anësor	6 m <sup>2</sup>	6,75 eur
15.5	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord një-anësor	6 m <sup>2</sup>	6,75 eur
16.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3455 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
17.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3475/1 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
18.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	3481/1 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
19.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2315/1 KK Tuz	Billbord dy-anësor	10 m <sup>2</sup>	11,25 eur
20.	Objekt i përkohshëm i lëvizshëm	2242 KK Tuz	Aparat hotlierik	2 m <sup>2</sup>	2,5 eur
26.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2229 KK Tuz	Objekt i përkohshëm hotelierik	30 m <sup>2</sup>	26,25 eur

28.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për servisim dhe larje automjetesh	150 m <sup>2</sup>	112,5 eur
29.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	150 m <sup>2</sup>	112,5 eur
31.1	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	397 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	150 m <sup>2</sup>	131,25 eur
31.2	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	397 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	150 m <sup>2</sup>	131,25 eur
35.	Sipërfaqe e hapur në funksion të objektit të përkohshëm	722 KK Tuz	Objekt sportiv – terren i hapur	2350 m <sup>2</sup>	88,12 eur
36.	Objekt i përkohshëm i palëvizshëm	1350/1 KK Tuz	Billbord	20 m <sup>2</sup>	17,5 eur
44.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2242 KK Tuz	Bankomat	1.50 m <sup>2</sup>	1,87 eur
48.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	3036 KK Tuz	Objekt për servisim dhe larje automjetesh	160 m <sup>2</sup>	80 eur
49.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	3034 KK Tuz	Objekt i përkohshëm hotelierik	150 m <sup>2</sup>	75 eur
54.	Objekt i përkohshëm i lëvizshëm	2242 KK Tuz	Aparat hotelierik	1 m <sup>2</sup>	1,25 eur
56.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
57.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
58.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	100 m <sup>2</sup>	75 eur
59.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt i përkohshëm hotelierik	200 m <sup>2</sup>	150 eur
60.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt i përkohshëm hotelierik	200 m <sup>2</sup>	150 eur
63.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	3200 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	170 m <sup>2</sup>	53,12 eur
64.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	1350/1 KK Tuz	Pano reklamuese	4 m <sup>2</sup>	3,5 eur
66.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
67.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
69.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
70.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur

72.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt i përkohshëm hotelierik	200 m <sup>2</sup>	150 eur
73.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2265 KK Tuz	Impiant i lëvizshëm për deponim, marrjen dhe dërgimin e karburantit	10 m <sup>2</sup>	1,25 eur
77.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur
96.	Objekt i përkohshëm montues-çmontues	2997/1 KK Tuz	Objekt për tregti dhe shërbime	200 m <sup>2</sup>	150 eur

**Në shumën e arritur të qirasë për të gjitha lokacionet përlllogaritet TVSH-ja që i ngarkohet qiramarrësit. TVSH-ja llogaritet gjatë lidhjes së kontratës së qirasë me ofertuesin më të favorshëm.**

#### **Kushtet e përgjithshme të thirrjes publike**

Trualli jepet me qira për një periudhë prej një viti, duke filluar nga dita e lidhjes së kontratës së qirasë. Lokacionet e shënuara me numrat 1.4; 1.5; 1.6; 1.7; 1.8 lëshohen me qira në periudhë prej: 01.04.2022 deri më 30.10.2022.

Nëse gjatë kohëzgjatjes së qirasë, trualli sillet në përdorimin e saj të synuar, marrëveshja e qirasë do të ndërpritet dhe qiramarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim në bazë të mjeteve të investuara. Të dhënat për lokacionin, llojet, tipin, sipërfaqen dhe pamjen e objektit të përkohshëm përcaktohen me Programin e objekteve të përkohshme të komunës së Tuzit 2020-2025 ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale", nr. 20/20) dhe Vendim për miratimin e ndryshimeve në Programin e objekteve të përkohshme për territorin e Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 46/21).

Ftesa publike do të vendoset në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e komunës së Tuzit tuzi.org.me dhe do të publikohet në të përditshmen "Pobjeda".

#### **Mënyra, vendi dhe koha e dorëzimit të aplikacioneve**

Aplikimet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur (në mënyrë që me rastin e hapjes së ofertës të konstatohet me siguri se do të hapet për herë të parë), me shënimin "**Aplikimi për mbledhjen e ofertave për lokacionin (numri i lokacionit) Komisionit për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave-mos të hapet para seancës zyrtare të komisionit**", drejtpërdrejt, në arkivin e komunës së Tuzit ose me postë në adresën Tuz pn, 81206 Tuz.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **14.03.2022 deri në 21.03.2022** vjet deri në **16 h**.

Aplikimet e dorëzuara pas afatit, si dhe aplikimet që nuk dorëzohen në zarf të mbyllur dhe nuk përmbajnë të gjitha të dhënat dhe provat e përcaktuara me ftesë, nuk do të merren parasysh dhe do t'i kthehen ofertuesit. Aplikantët nga paragrafi paraprak nuk do të mund të regjistrohen në Komision.

Formulari i aplikimit mund të merret në arkivin e komunës së Tuzit.

#### **Aplikimi dhe shpenzimet - detyrimet e procedurës**

Aplikimi me shkrim duhet të përmbajë:

- **për personin juridik:** emri dhe selia e personit juridik, dëshmi - vendimi mbi regjistrimin me certifikatën e RQSA (regjistrin qendror të subjekteve afasite) (origjinali ose kopje e vërtetuar e vendimit), emri dhe mbiemri i drejtorit dhe nënshkrimi i tij, autorizimi – autorizimi për pjesëmarrje në tender publik, numër llogarie bankare për kthimin e depozitit, numër telefoni, dhe vula.
- **për personat fizikë:** mbiemri dhe emri, numri unik amzë, numri i letër njoftimit ose i dokumentit të udhëtimit (pasaporta), adresa, numri i llogarisë bankare për kthimin e depozitit , numri i telefonit.
- -shënimi (numri) i vendndodhjes së përkohshme me të cilën lidhet oferta.
- - vërtetimin e shpenzimeve të paguara për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave në vlerë prej 20,00 € me shënimin “pjesëmarrje në procedurën e mbledhjes së ofertave” në llogarinë bankare të komunës së Tuzit numër 530-27038-88 pranë NLB Bank.
- - Vërtetim për pagesën e depozitës në vlerë prej 3 (tre) çmimeve të qirasë minimale mujore pa TVSH për lokacionin për të cilin oferta i referohet në xhiro llogarinë e komunës së Tuzit numër 530-27038-88 pranë bankës NLB.
- Vërtetim nga Sekretariati për financa mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj Komunës së Tuzit.
- Shuma e formuar e qirasë mujore për një lokacion të caktuar, e shprehur në euro pa TVSH.

Nëse ofertuesi është person juridik i huaj, dokumentacionin e lëshuar nga organi kompetent nga shteti në të cilin është themeluar shoqëria, është i obliguar ta dorëzojë në gjuhën malazeze, të vërtetuar nga përkthyesi gjyqësor.

**Vërejtje:** Nëse personi dorëzon më shumë se një kërkesë për të njëjtin lokacion do të merret në konsideratë oferta e cila përmban çmimin më të lartë të ofruar.

**Shpenzimet që përdoren për zhvillimin e procesit të tenderit nuk kthehen.**

**Depozita e paguar u kthehet ofertuesve të pazgjedhur brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm dhe ofertuesit e përzgjedhur do të përfshihen në shumën e qirasë me rastin e lidhjes së kontratës së qirasë.**

#### **Vendi dhe koha e hapjes së ofertave**

Hapja e ofertave do të bëhet në datën **24.03.2022 duke filluar nga ora 10 h** në objektin e komunës së Tuzit. Aplikantët pjesëmarrës për pjesëmarrjen në procedurën e mbledhjes së ofertave janë të detyruar të regjistrohen në Komisionin gjysmë ore para fillimit të procedurës.

Prania fizike e palëve të interesuara është e detyrueshme për pjesëmarrje në procedurën e hapjes së ofertave, në të kundërtën ofertat me shkrim pa prani fizike nuk do të merren parasysh.

#### **Zgjedhja e ofertuesit më të mirë**

Pjesëmarrësi i ranguar si ofertuesi më i mirë do të trajtohet pjesëmarrësi i cili jep ofertën më të mirë.

Për derisa oferta është e pavlefshme ose nuk pranohet, depozita i kthehet ofertuesit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e zhvillimit të procedurës.

Në rast se ofertuesi më i favorshëm tërhiqet nga qiraja pas hapjes së ofertës, ai humbë të drejtën e kthimit të depozitës dhe ofertuesi tjetër më i favorshëm do të ftohet për të lidhur marrëveshjen e qirasë.

Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të favorshme:

- çmimi më i lartë i ofruar ..... 70 pikë;
- përdorimi i vendndodhjes në periudhën e mëparshme ..... 30 pikë;

Pikët për kriterin e shfrytëzimit të lokacionit në periudhën paraprake fitohen nëse ofertuesi dorëzon vendim për kryerjen e veprimtarive për vitin paraprak për të njëjtin lokacion dhe nëse nuk e ka shkëputur kontratën

në mënyrë të njëanshme ose ka hequr dorë nga zbatimi i kontratës dhe nëse ka shlyer plotësisht detyrimet e pagesës në bazë të kontratës mbi qiranë për vitin paraprak për lokacionin e njëjtë.

Nëse konstatohet se dy ose më shumë ofertues kanë të njëjtin numër pikësh, ofertuesi më i favorshëm do të konsiderohet ofertuesi, oferta e të cilit ka mbërritur e para në kohë.

Vendimin për përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm e merr Komisioni për zhvillimin e procedurës së mbledhjes së ofertave brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Ajo do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e komunës së Tuzit [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së vendimit. Njoftimet e veçanta për rezultatin e procedurës do të dërgohen nga Komisioni për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave për të gjithë pjesëmarrësit që kanë dorëzuar oferta korrekte dhe të rregullta brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave.

Pjesëmarrësit në procedurë kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin për përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së lajmërimit gjegjësisht nga dita publikimit të vendimit, nëse lajmërimi nuk është i nevojshëm të dorëzohet në pajtim me dispozitat e kësaj ftese publike. Komisioni do të zbatojë dispozitat e Ligjit për Procedurën administrative në procedurën e ankesës.

Vendimi i Komisionit për ankesën është përfundimtar. Pas përfundimit të vendimit, Komisioni i dërgon një njoftim përfundimtar ofertuesit më të favorshëm, prej së cilës fillon afati për lidhjen e kontratës.

#### **Lidhja e kontratës**

Sekretariati për Pronën do të lidhë kontratë qiraje me ofertuesin e përzgjedhur brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të njoftimit për përfundimin e vendimit për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme.

**Shuma totale e qirasë për gjithë kohëzgjatjen e qirasë paguhet me rastin e lidhjes së marrëveshjes së qirasë së truallit.**

Informacion më të detajuar për procedurën e tenderit publik mund të merrni çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në 16:00 në tel. 020/875-167, te Komisionit për zbatimin e procedurës së mbledhjes së ofertave.

#### **KOMUNA E TUZIT SEKRETARIATI PËR PRONË**

**U.D. Sekretare,**

**Elvisa Redžematović**



**Numër:09-032/22-2862**

**Tuz, më 11.03. 2022**